



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 264/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të autoritetit kontraktor në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “ITE Grup” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-04948-01-24-2019, me objekt: “*Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues*”, me fond limit 13 333 312 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 26.02.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder.”

Ankimues: “ITE Grup” sh.p.k
Autostrada Tiranë-Durrës, Ruga dytësore, Km 5

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkoder
Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.01.2019 është publikuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-04948-01-24-2019, me objekt: “Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 13 333 312 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 26.02.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder.

II.2. Në datën 18.03.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Euro Alb” sh.p.k	10.968.960 lekë, skualifikuar
2. “Klosi – R” sh.p.k	11.900.000 lekë, skualifikuar
3. “Alen Co” sh.p.k	12.791.424 lekë, skualifikuar
4. “Hest” sh.p.k	12.952.960 lekë, skualifikuar
5. “ITE Grup” sh.p.k	13.093.780 lekë, skualifikuar

Operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga KVO-ja me argumentin e mëposhtëm: *-Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme nuk është sipas shtojces nr.8 të DST pasi mungon pjesa ku autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik.*”

II.3. Në datën 20.03.2019 operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet se:

“Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme është plotësuar nga ana jonë në të gjithë pikat sipas kërkesave të shtojcës. Shprehja e munguar është një informacion standard që nuk trajtohet nga ana

jonë dhe nëse si operator nuk përcaktojmë të drejtën ose jo për verifikimin e dokumentave shtetërore nga ana e autoritetit kontraktor. Gjithashtu ju përmendim që kjo shtojcë nuk ndikon në vlerën ekonomike dhe ofertën teknike të paraqitur nga ana jonë.”

II.5. Nëpërmjet shkresës Nr. 4437/1 Prot., datë 25.03.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit, duke e refuzuar ankesën, si vijon:

“[...] Nga shqyrtimi i shtojcës 8 të DST, Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme objekt ankimi, të hedhur në SPE nga ankimesi, rezulton se ajo nuk është konform shtojcës 8 të DST, të publikuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi mungon pjesa ku autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik. Është detyrim i ofertuesit që në përgatitjen e dokumentacionit për tender të mos bëjë asnjë ndryshim apo modifikim të shtojcave të cilat duhet të plotësohen me rigorozitet sipas DST.”

II.6. Në datën 01.04.2019 operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7. Në datën 12.04.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 580/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 5882 prot., datë 10.04.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimesi “ITE Grup” sh.p.k se: “Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme nuk është sipas shtojcës nr.8 të DST pasi mungon pjesa ku autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 të dokumentave të tenderit të publikuar në SPE rezulton se është kërkuar si më poshtë vijon:

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

III.1.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit” është parashikuar si vijon:

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

III.1.3. Në nenin 45, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”, është përcaktuar:

“1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij”

2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefshëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronja “a”, “b” dhe “c”.

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

III.1.4. Në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.5. Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k rezulton se është paraqitur deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, ku deklarohet se:

Operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- *Operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*
- *Operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,*
- *Operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),*
- *Operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Data e dorëzimit të deklaratës 26.02.2019

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

III.1.6. Operatorët ekonomikë kanë detyrimin ligjor të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Pra autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “ITE Grup” sh.p.k” sh.p.k, është deklaruar se i përmbush të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktor, të parashikuara në shtojcën 8 të dokumentave të tenderit, pasi nga ana e tij është deklaruar se nuk ndodhet në asnjë prej kushteve që përbën arsye skualifikimi, sic përcaktohet në nenin 45 të LPP-së si më sipër cituar.

III.1.7. Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai bazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këtë kontekst operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k” sh.p.k plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në përputhje me nenin 45 të LPP-së si më sipër cituar.

Përsa i përket konstatimit të autoritetit kontraktor se në deklaratën mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit mungon pjesa ku autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, sqarojmë se ligji i prokurimit publik dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ia njohin këtë të drejtë autoritetit kontraktor për të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e paraqitur në ofertë, kur ka dyshime për vërtetësinë e informacionit të paraqitur në këtë ofertë.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ITE Grup” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-04948-01-24-2019, me objekt: “Blerje materiale rehabilituese për mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues”, me fond limit 13 333 312 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 26.02.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkoder.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ITE Grup” sh.p.k, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ITE Grup” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 580 Protokolli,

Datë 01.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar Vilma Zhupaj	Anëtar Lindita Skeja	Anëtar Merita Zeqaj
Kryetar Evis Shurdha		